

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN** - Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjykatëses së vetme gjykuese, Luljete Shabani, me praktikanten Edona Selimi, në lëndën penale kundër të akuzuarit F.K. nga fsh. ..., K. e ..., për veprën penale **Sulmi nga neni 187 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 te KPRK-së**, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II. nr. 1611/16, të datës 31.08.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 28.06.2018, bie dhe në prezencë të palëve mori dhe shpalli, ndërsa më 29.06.2018 përpiloi këtë:

## AKTGJYKIM

I akuzuari F.K., nga babai I. dhe nëna N., e lindur D., i lindur më datë ... në ..., jeton në fsh. ..., K. e ..., i martuar, ka te kryer shkollën e mesme, i papunë, i gjendjes se mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i padënuar më parë dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër penale ndaj tij,

## ËSHTË FAJTOR

Sepse, më datë 23.08.2016, rreth orës 22:34 min. në Gjilan, me dashje ka përdorë forcë ndaj të dëmtuarës, viktimës së ndjeshme, F.Sh., me të cilën ka bashkëjetuar, në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje e ka sulmuar fizikisht, duke e goditur me shuplakë fytyrës dhe me rrip pantallonash në gjithë trupin,

-me çka ka kryer veprën penale **Sulmi nga neni 187 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 te KPRK-së** andaj, Gjykata, në bazë të dispozitave të neneve 7, 17, 21, 51, 73, 114 të KPRK-së dhe nenit 365, 453 dhe 463 të KPPRK-së,

## E GJYKON ME DËNIM ME KUSHT

**Dënim Burgu** në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në kohën prej 1 (një) viti, nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën gjykata dënimin me kusht do ta revokojë.

**Obligohet** i akuzuari që të paguaj **paushallin gjyqësor** në shumë prej 15 (pesëmbëdhjetë) €, si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar, **udhëzohet në kontest juridiko-civil**, për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

## Arsye t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP. II nr. 1611/2016, të datës 31.08.2016, kundër të akuzuarit F.K., për shkak të veprës penale **Sulmi nga neni 187 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 te KPRK-së**, dhe ka kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet me dënim meritor sipas ligjit.

*Meqenëse i akuzuari e pranoi fajsinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, gjykatësja nuk pati nevojë të administroj provë të tjera.*

*Me rastin e caktimit dhe llojin e lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari pati sjellje korrekte në Gjykatë, se është pënduar për veprën në fjalë, ndërsa, si rrethanë rënduese, mori shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-së.*

*Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPPRK-së.*

*Nga të cekurat më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM  
P.nr. 1060/16, më datë 29.06.2018**

*Praktikantja,  
Edona Selimi*

*Gjykatësja e vetme gjykuese,  
Luljete Shabani*

***KËSHILLA JURIDIKE:*** *Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplarë, përmes kësaj Gjykate.*